



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 12-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 28.10.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Diamat Bytyqi, nënkryetar i komunës
2. Shkelzen Hajdini, DSH
3. Imri Smetishti, DPUMM

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti ***Merita Bytyqi***.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, të cilën e lexoi në vazhdim.

Aprovimi i ekstraktit të proceverbalit nga mbledhja e 14-të e Kuvendit.

2. Informata për punën e BKSB-së, për vitin 2022.
3. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2022, deri më 16.01.2023.
4. Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2023-2027 (Rishikim).
5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kompaninë Rajonale të Mbetjeve "Pastrimi" Sh.A.
6. Propozim Vendim për lirim nga pagesa të borxheve jofitimprurëse të qirasë të përfituesve të banesave sociale.

7. Raport i punës së Komisionit për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.
8. Deklarata e Kuvendit të Komunës në mbështetje të kërkesës së qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 7 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj Kryesuesi tha se raportet dhe inoformatat a jeni që të kalojnë direkt në Kuvend?

Me të gjitha votat, 7 për, u aprovua propozimi që raportet (pikat 2,3,5,6)

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 11-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 11-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

IV

Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2023-2027 (Rishikim).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Anëtarët e kuvendit dhënë disa propozime të cilat drejtori tha se do të merren parasysh

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kompaninë Rajonale të Mbetjeve "Pastrimi" Sh.A.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa të borxheve jofitimprurëse të qirasë të përfituesve të banesave sociale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemit, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, drejtor i DSH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:00

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi